

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar
i Avancuar**

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme!

Data 23.06.2024

1. Buzuku sh.a, një entitet biznesi ka blerë dy filiale dhe një ortakëri. Draft pasqyra e pozitës financiare për çdo entitet më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

| | Buzuku sh.a €'milion | Migjeni sh.a €'milion | Fishta sh.a €'milion |
|--|-------------------------|--------------------------|-------------------------|
| Pasuritë | | | |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese</i> | | | |
| Pasuritë e patun., imp. e prodh. dhe paisjet | 265 | 230 | 161 |
| Investimet në filiale: | | | |
| Migjeni sh.a | 300 | | |
| Fishta sh.a | 128 | | |
| Investimet në ortakëri- Çabej sh.a | 20 | | |
| Pasuritë financiare nepermjet TTGJ | <u>51</u> | <u>6</u> | <u>5</u> |
| | 764 | 236 | 166 |
| <i>Pasuritë qarkulluese</i> | | | |
| Stoqet | 135 | 55 | 73 |
| Të arkëtueshmet tregtare | 91 | 45 | 32 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | <u>102</u> | <u>100</u> | <u>8</u> |
| | <u>328</u> | <u>200</u> | <u>113</u> |
| Total pasuritë | 1,092 | 436 | 279 |
| Ekuiteti dhe detyrimet | | | |
| <i>Ekuiteti</i> | | | |
| Kapitali aksionar | 520 | 220 | 100 |
| Fitimet e mbajtura | 240 | 150 | 80 |
| Komponentë të tjerë të ekuitetit | <u>12</u> | <u>4</u> | <u>7</u> |
| Total ekuiteti | 772 | 374 | 187 |
| <i>Detyrimet afatgjata</i> | | | |
| Huamarrjet afatgjata | <u>145</u> | <u>24</u> | <u>8</u> |
| | 145 | 24 | 8 |
| <i>Detyrimet afatshkurtra</i> | | | |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera | 115 | 30 | 60 |
| Tatimi aktual i pagueshëm | <u>60</u> | <u>8</u> | <u>24</u> |
| | <u>175</u> | <u>38</u> | <u>84</u> |
| Total detyrimet | <u>320</u> | <u>62</u> | <u>92</u> |
| Total ekuiteti dhe detyrimet | 1,092 | 436 | 279 |

Informatat e mëposhtme janë të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të grupit:

i) Më 1 janar 2023, Buzuku sh.a bleu 80% të aksioneve të ekuitetit të Migjeni sh.a, një kompani private. Vlera e blerjes ishte €300 milionë. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Migjeni sh.a ishte €400 milionë, duke përfshirë çdo detyrim tatimor të shtyrë që lind nga blerja. Pronarët e Migjeni sh.a duhej të shitnin kompaninë për qëllime tatimore deri në një datë të caktuar dhe, për rrjedhojë, ia shitën kompanisë së parë që ofertoj për të, e cila ishte Buzuku sh.a. Një vlerësues i pavarur ka deklaruar se vlera e drejtë e interesit jo kontrollues në Migjeni sh.a ishte €86 milionë më 1 janar 2023. Buzuku sh.a nuk dëshiron të masë interesin jo kontrollues në filialet bazuar në interesin proporcional në pasuritë neto të identifikueshme, por dëshiron të përdorë

metodën e vlerës së drejtë (emrit të mirë të plotë). Fitimet e pashpërndara të Migjeni sh.a ishin €136 milionë dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €4 milionë në datën e blerjes. Nuk kishte pasur asnjë emetim të ri të aksioneve nga Migjeni sh.a që nga data e blerjes dhe tejkalimi i vlerës së drejtë të pasurive neto është për shkak të rritjes së vlerës së tokës së pa zhvlerësueshme.

ii) Më 1 janar 2022, Buzuku sh.a bleu 6% të aksioneve të zakonshme të Fishta sh.a. Buzuku sh.a e kishte trajtuar këtë investim si një pasuri financiare nëpërmjet TTGJ në pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor 2022, por e kishte rideklaruar investimin me kosto kur Fishta sh.a u bë filial. Më 1 janar 2023, Buzuku sh.a bleu 64% të tjera të aksioneve të zakonshme të Fishta sh.a dhe fitoi kontrollin e kompanisë. Konsiderata për blerjet ishte si më poshtë:

| | Pronësia | Konsiderata |
|---------------------|-----------------|--------------------|
| | % | €'milion |
| 1 janar 2022 | 6 | 10 |
| 1 janar 2023 | <u>64</u> | <u>118</u> |
| | 70 | 128 |

Sipas marrëveshjes së blerjes, më 1 janar 2023, Buzuku sh.a u kërkohet t'u paguajë ish-aksionarëve 30% të fitimeve të Fishta sh.a më 31 dhjetor 2024 për secilin nga vitet financiare deri më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2024. Vlera e drejtë e kësaj marrëveshje ishte vlerësuar në €12 milionë më 1 janar 2023, dhe më 31 dhjetor 2023, kjo vlerë nuk kishte ndryshuar. Kjo shumë nuk është përfshirë në pasqyrat financiare.

Më 1 janar 2023, vlera e drejtë e interesit të ekuitetit në Fishta sh.a të mbajtur nga Buzuku sh.a përpara kombinimit të biznesit ishte €15 milionë. Vlera e drejtë e interesit jo kontrollues në Fishta sh.a ishte €53 milionë.

Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme në 1 janar 2023 të Fishta sh.a ishte €170 milion, dhe fitimet e pashpërndara dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin përkatësisht €55 milionë dhe €7 milionë. Nuk kishte pasur asnjë emetim të ri të aksioneve të zakonshme nga Fishta sh.a që nga data e blerjes dhe tejkalimi i vlerës së drejtë të pasurive neto është për shkak të rritjes së vlerës së pasurive të patundshme, impianteve të prodhimit dhe paisjeve (PPIPP). Vlera e drejtë e PPIPP ishte e përkohshme në pritje të marrjes së vlerësimeve përfundimtare për këto pasuri. Këto vlerësime janë pranuar më 1 korrik 2023 dhe kanë rezultuar në një rritje të mëtejshme prej €6 milionë në vlerën e drejtë të pasurive neto në datën e blerjes. Kjo rritje nuk ndikon në vlerën e drejtë të interesit jo kontrollues. PPIPP zhvlerësohen në bazë lineare gjatë 7 viteve. Injoroni çdo implikim tatimor.

iii) Buzuku sh.a bleu një interes prej 10% në Çabej sh.a, më 1 janar 2022 për €8 milionë. Investimi është kontabilizuar si pasuri financiar përmes TTGJ dhe më 31 dhjetor 2022 vlera e tij ishte €9 milionë. Më 1 janar 2023, Buzuku sh.a bleu një interes shtesë 15% në Çabej për €11 milionë dhe arriti influencë domethënëse. Çabej sh.a realizoi fitime pas dividendëve prej €6 milionë dhe €10 milionë e për vitet deri më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2023.

iv) Më 1 janar 2022, Buzuku sh.a bleu një instrument të ekuitetit të huaj prej 11 milionë lek shqiptar (ALL) në vlerën e tij të drejtë. Instrumenti u klasifikua si pasuri financiare nëpërmjet TTGJ. Kurset përkatëse të këmbimit dhe vlerat e drejta ishin si më poshtë:

| | 1 ALL | Vlera e drejtë e instrumentit milion ALL |
|-----------------|--------------|---|
| 1 janar 2022 | €4.5 | 11 |
| 31 dhjetor 2022 | €5.1 | 10 |
| 31 dhjetor 2023 | €4.8 | 7 |

Buzuku sh.a nuk ka regjistruar asnjë ndryshim në vlerën e instrumentit që nga data 31 dhjetor 2022. Rënia e vlerës së drejtë më 31 dhjetor 2023 konsiderohet të jetë si rezultat i dëmtimit.

v) Nuk ka asnjë dëmtim të zërit të mirë që lind në blerjet.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare më 31 dhjetor 2023 për Grupin Buzuku sh.a. (20 pikë)

Zgjidhja e detyrës 1

Grupi Buzuku

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023

| Pasuritë: | €m |
|---|----------------|
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i> | |
| Pasuritë e patun., imp. e prodh. dhe paisjet (265+230+161+40+14-2)L17 | 708 |
| Zëri i mirë L12 | 22 |
| Investimi në ortakëri L13 | 22.5 |
| Pasuritë financiare në dispozicion për shitje (51+6+5-17.4) | <u>44.6</u> |
| | 797.1 |
| <i>Pasuritë qarkulluese:</i> | |
| Stoqet (135+55+73) | 263 |
| Të arkëtueshmet tregtare (91+45+32) | 168 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë (102+100+8) | <u>210</u> |
| | <u>641</u> |
| Total pasuritë | 1,438.1 |
| Ekuiteti dhe detyrimet | |
| Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit | |
| Kapitali aksionar | 520 |
| Fitimet e mbajtura L15 | |
| Komponentë të tjerë të ekuitetit L15 | 273.9 |
| | <u>9.5</u> |
| | 803.4 |
| Interesi jo-kontrollues L17 | <u>148.7</u> |
| | 952.1 |
| <i>Detyrimet afatgjata</i> | |
| Huamarrjet afatgjata (145+24+8) | <u>177</u> |
| Total detyrimet afatgjata | 177 |
| <i>Detyrimet afatshkurtra</i> | |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (115+30+60+12) | 217 |
| Tatimi aktual i pagueshëm (60+8+24) | 92 |
| Total detyrimet afatshkurtra | <u>309</u> |
| Total detyrimet | <u>486</u> |
| Total Ekuiteti dhe detyrimet | 1,438.1 |

Llogaritjet

1. Struktura e grupit

| | Migjeni sh.a | Fishta sh.a | Çabej sh.a |
|------------------------------------|---------------------|--------------------|--------------------|
| Interesi i Buzukut sh.a | 80% | 70% | 25% |
| IJK/Interesi i jashtëm | <u>20%</u> | <u>30%</u> | <u>75%</u> |
| | 100% | 100% | 100% |
| | 1 vit filial | 1 vit filial | 1 vit ortakëri |
| Neto pasuritë: Migjeni sh.a | Në raportim | Në blerje | Pas blerjes |
| Kapitali aksionar | 220 | 220 | - |
| Fitimet e mbajtura | 150 | 136 | 14 |
| Komponentë të tjerë të ekuitetit | 4 | 4 | - |
| Korigjimet e VD - Toka | <u>40</u> | <u>40</u> | <u>-.</u> |

| | | | |
|-----------------------------------|--------------------|------------------|--------------------|
| | 414 | 400 | 14 |
| Neto pasuritë: Fishta sh.a | Në raportim | Në blerje | Pas blerjes |
| Kapitali aksionar | 100 | 100 | - |
| Fitimet e mbajtura | 80 | 55 | 25 |
| Komponentë të tjerë të ekuitetit | 7 | 7 | - |
| Korrigjimet e VD - PIPP | <u>12</u> | <u>14 (8+6)</u> | <u>(2)</u> |
| | 199 | 176 | 23 |

2. Emri i mirë

Migjeni sh.a:

| | | |
|--|------------------------------------|--------------|
| | | €m |
| Vlera e drejtë e konsideratës për interesin prej 80% | | 300 |
| Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues | | <u>86</u> |
| | | 386 |
| Shuma e pasurive neto të identifikueshme të blera | | <u>(400)</u> |
| Fitimi në blerjen me zbritje | | (14) |
| Hyrjet do të jenë: | | |
| Debi | Neto pasuritë e identifikueshme | 400 |
| Kredi | Paraja | 300 |
| Kredi | Fitimi në blerjen me zbritje | 14 |
| Kredi | Ekuiteti - interesi jo-kontrollues | 86 |

Fishta sh.a:

| | |
|--|------------|
| | €m |
| 1 janar 2023 (128 - 10) | 118 |
| Konsiderata kontigjente | <u>12</u> |
| Total konsiderat e transferuar | 130 |
| Vlera e drejtë e interesit në ekuitet e mbajtur përpara kombinimit të biznesit | <u>15</u> |
| Vlera e drejtë e konsideratës | 145 |
| Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues | <u>53</u> |
| | 198 |
| Neto pasuritë e identifikueshme | (170) |
| Rritja në vlerë | <u>(6)</u> |
| Emri i mirë | 22 |

3. Investimi në ortakëri - Çabej sh.a

Fitimi prej 1 i regjistruar brenda ekuitetit tjetër tani duhet të konsiderohet i realizuar pasi pjesëmarrja të jetë rritur në 25%. Kërkohet një rregullim për të riklasifikuar këtë fitim

| | | |
|-------|--|---|
| Debi | Komponentë të tjerë të ekuitetit (9 - 8) | 1 |
| Kredi | Fitimi ose humbja (Fitimet e mbajtura) | 1 |

Shuma e përfshirë në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare do të ishte:

| | |
|---|-------------|
| | €m |
| Kosto (€9 milion + €11 milion) | 20 |
| Pjesa e fitimeve pas blerjes (€10 milion x 25%) | <u>2.5</u> |
| | 22.5 |

4. Pasuritë financiare nepermjet TTGJ

| Data | Kursi i këmbimit | Vlera ALL m | Vlera €m | Ndryshimi në vlerë €m |
|-----------------|------------------|----------------|-------------|--------------------------|
| 1 janar 2022 | 4.5 | 11 | 49.5 | |
| 31 dhjetor 2022 | 5.1 | 10 | 51 | 1.5 |
| 31 dhjetor 2023 | 4.8 | 7 | 33.6 | (17.4) |

Vlera e drejtë e pasurisë në valutën e huaj ka rënë për periudha të njëpasnjëshme. Megjithatë, asnjë humbje nga dëmtimi nuk njihet në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 pasi nuk ka humbje në valutën raportuese (€). Fitimi prej €1.5 milion do të regjistrohej në ekuitet. Megjithatë, në vitin deri më 31 dhjetor 2023, një humbje nga dëmtimi prej €17.4 milion do të regjistrohet si më poshtë:

| | |
|--|------|
| Debi Komponentë të tjerë të ekuitetit | 1.5 |
| Debi Fitimi ose humbja | 15.9 |
| Kredi Pasuritë financiare nepermjet TTGJ | 17.4 |

5. Fitimet e mbajtura

€m

Buzuku sh.a:

| | |
|--|--------------|
| Saldo me 31 dhjetor 2023 | 240 |
| Fitimet e ortakërisë (25% x 10) | 2.5 |
| Dëmtimi i pasurisë financiare L14 | (15.9) |
| Kritja në vlerën e drejtë në Çabej sh.a e realizuar | 1 |
| Kritja në vlerën e drejtë të interesit në ekuitet- Fishta sh.a (15 - 10) | 5 |
| Fitimi në blerjen me zbritje | 14 |
| Rezervat pas blerjes: | |
| Migjeni sh.a: (150 -136) x 80% | 11.2 |
| Fishta sh.a: [(80-55) - 2] x 70% | <u>16.1</u> |
| | 273.9 |

Buzuku sh.a: Komponentë të tjerë të ekuitetit

€m

| | |
|-----------------------------------|--------------|
| Saldo me 31 dhjetor 2023 | 12 |
| Investimi në ortakëri L13 | (1) |
| Dëmtimi i pasurisë financiare L14 | <u>(1.5)</u> |
| | 9.5 |

6. Interesi jo-kontrollues

€m

| | |
|---|--------------|
| Migjeni sh.a | 86 |
| Pjesa e rezervave pas blerjes (20% x 14) | <u>2.8</u> |
| | 88.8 |
| Fishta sh.a | 53 |
| Pjesa e rezervave pas blerjes [(80-55)-2] x 30% | <u>6.9</u> |
| | <u>59.9</u> |
| Total | 148.7 |

| | |
|--|------------|
| 7. Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet | €m |
| Buzuku sh.a | 265 |
| Migjeni sh.a | 230 |
| Fishta sh.a | <u>161</u> |
| | 656 |
| Rritja në vlerën e tokës - Migjeni sh.a (400 - 220 - 136 - 4) | 40 |
| Rritja në vlerën e PPIPP - Fishta sh.a (176 - 100 - 55 - 7) | 14 |
| Minus: zhvlerësimi shtesë (14/7) | <u>(2)</u> |
| | 708 |

2.

a) Konstadin Kristoforidhi sh.a ka në pronësi një makinë shpimi për gjashtë (6) vitet e fundit. Makina është përdorur në disa projekte, duke gjeneruar 23% të të ardhurave totale të kompanisë. Vitet e fundit, kompania ka përjetuar një konkurrencë të paprecedentë në biznesin e shpimit, e cila ka sjellë një ulje drastike të të ardhurave nga ky biznes në rreth 7% të të ardhurave totale të kompanisë. Ky trend pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen e parashikueshme. Prandaj, menaxhmenti po mendon të braktisë makinën e shpimit më 30 qershor 2023 dhe në këtë mënyrë e ka klasifikuar atë si 'të mbajtur për shitje' më 31 dhjetor 2023. Më tej, kompania bleu një tokë me një kosto prej €100,000 më 1 janar 2023. Kompania deri më 31 dhjetor 2023 nuk ka vendosur se çfarë të bëjë me këtë tokë. Toka ka një vlerë të drejtë prej €110,000 në fund të vitit më 31 dhjetor 2023.

Kërkohet:

Këshilloni se si Konstadin Kristoforidhi sh.a duhet të kontabilizoj makinën e shpimit dhe tokën me 31 dhjetor 2023. (5 pikë)

(b) SNK 41 *Bujqësia*, jep udhëzime për kontabilitetin e aktivitetit bujqësor. Pasuritë biologjike, prodhimet bujqësore në momentin e vjeljes dhe grantet qeveritare në lidhje me pasuritë biologjike janë brenda fushëveprimit të SNK 41.

Kërkohet:

Paraqisni kërkesat e SNK 41 *Bujqësia*, në lidhje me njohjen dhe matjen e pasurive biologjike dhe prodhimeve bujqësore në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. (5 pikë)

(c) SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë* jep udhëzime për matjen e vlerës së drejtë kur një SNRF specifike kërkon ose lejon vlerën e drejtë si bazë matjeje. Ai siguron një kornizë të vetme të SNRF-ve për matjen e vlerës së drejtë dhe kërkon dhënie informacionesh shpjeguese për matjen e vlerës së drejtë.

Kërkohet:

Përshkruani kërkesat e përgjithshme të SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë* në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë dhe hierarkisë së vlerës së drejtë. (5 pikë)

(d) Instrument financiar është çdo kontratë që sjell deri te pasuria financiare dhe detyrimi financiar ose instrumenti i ekuitetit të një entiteti tjetër.

Kërkohet:

Shpjegoni njohjen fillestare, matjet dhe klasifikimet që SNRF 9 *Instrumentet financiare* identifikon për pasuritë financiare dhe bazën e matjes që është e përshtatshme për çdo klasifikim. Në përgjigjen tuaj, tregoni qartë çdo përjashtim nga klasifikimet normale që mund të zbatohen në rrethana specifike. (5 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës 2.

a)

Makina e shpimit

SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera* kërkon që një paauri, vlera e të cilës do të realizohet nëpërmjet shitjes, të klasifikohet si e mbajtur për shitje për sa kohë që plotësohen disa kritere. Këto përfshijnë sa vijon:

- Pasuria duhet të jetë në dispozicion për shitje të menjëhershme në kushtet e saj aktuale.
- Shitja e saj duhet të jetë shumë e mundshme (pra, të ketë më shumë mundësi për po se sa për jo).

Që shitja të jetë shumë e mundshme, duhet të jenë të zbatueshme elementet e mëposhtme.

- Menaxhmenti duhet të jetë i angazhuar ndaj një plani për të shitur pasurinë.
- Duhet të ketë një program aktiv për të gjetur një blerës.
- Pasuria duhet të jetë vënë për shitje me një çmim i cili është arsyeshmërisht në përputhje me vlerën e drejtë aktuale.
- Shitja duhet të pritet të kryhet brenda një viti nga data e klasifikimit.
- Ka shumë pak gjasa që planit t'i bëhen ndryshime të rëndësishme ose që plani të tërhiqet.

Në të kundërtën, një pasuri që do të braktiset, përveç një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit, nuk duhet të klasifikohet si e mbajtur për shitje. Kjo për shkak se vlera kontabël e saj do të rikuperohet duke vazhduar përdorimin.

Prandaj, makina e shpimit nuk duhet të klasifikohet si e mbajtur për shitje pasi nuk i plotëson kriteret e njohjes. Vlera kontabël e saj do të realizohet nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm dhe jo nëpërmjet shitjes. Kompania duhet të vazhdojë të mbajë kontabilitetin e makinës sipas SNK 16 *Prona, impiantet dhe pajisjet*. Gjithashtu, rënia e vazhdueshme e kontributit të të ardhurave nga pasuria është një tregues i dëmtimit. Prandaj, pasuria duhet të rishikohet për dëmtim. Nëse vlera kontabël e saj rezulton të jetë më e madhe se vlera e rikuperueshme, ajo duhet të reduktohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi të merret në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Toka

Toka e blerë për përdorim në operacionet e biznesit tregohet si pjesë e pasurive afatgjata materiale dhe kontabilizohet sipas SNK 16 *Prona, impiantet dhe pajisjet* Megjithatë, kur një entitet ende nuk ka vendosur për përdorimin e saj, atëherë ajo duhet të klasifikohet si investim në pasuri të patundshme dhe të kontabilizohet sipas SNK 40 *Investimet në pasuri të patundshme*. Toka do të njihet fillimisht në €100,000 dhe më pas në €110,000 për të pasqyruar vlerën e saj të drejtë më 31 dhjetor 2023. Rritja në vlerën e drejtë prej €10,000 do të njihet si një fitim në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kjo është në përputhje me modelin e vlerës së drejtë të SNK 40 *Investimet në pasuri të patundshme*. Megjithatë, sipas modelit të kostos të SNK 40, toka do të mbartet me koston e saj prej €100,000, subjekt i rishikimit për dëmtim. Toka nuk duhet të zhvlerësohet sipas këtij modeli

(b) SNK 41 Bujqësia

Njohja

Pasuritë biologjike ose prodhimet bujqësore njihen kur:

- (a) Entiteti kontrollon pasuritë si rezultat i ndodhive të kaluara
- (b) Është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të shoqëruara me pasurinë do të rrjedhin tek entiteti
- (c) Vlera e drejtë ose kostoja e pasurisë për entitetin mund të matet në mënyrë të besueshme

Matja

Pasuritë biologjike

Pasuritë biologjike brenda fushëveprimit të SNK 41 maten në njohjen fillestare dhe në datat e mëpasshme të raportimit me vlerën e drejtë minus kostot e vlerësuara të shitjes, përveç rastit kur vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme.

Nëse nuk ka matje të besueshme të vlerës së drejtë (pa çmim të kuotuar tregu në një treg aktiv dhe matjet alternative të vlerës së drejtë të pabesueshme), pasuritë biologjike paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

Nëse rrethanat ndryshojnë dhe vlera e drejtë bëhet e matshme me besueshmëri, kërkohet një kalim në vlerën e drejtë minus kostot.

Produkti bujqësor

Produkti bujqësor matet në secilin fundvit me vlerën e drejtë minus kostot e përlllogaritura të pikës së shitjes, në shkallën që është caktuar në burim nga entiteti i pasurive biologjike, të cilat poashtu vlerësohen me vlerë të drejtë. Kjo është logjike kur konsideroni, se deri në korrije, produkti bujqësor është vlerësuar me vlerë të drejtë si pjesë e pasurisë biologjike. Ndryshe nga një pasuri biologjike, nuk ka përjashtim në rastet kur vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri. Sipas SNK 41, prodhimi bujqësor mund të matet gjithmonë me besueshmëri sepse prodhimi i korrur është një mall i tregtueshëm.

Kostot e pikës së shitjes përfshijnë komisionet e ndërmjetësve dhe tregtarëve, çdo taksë nga autoritetet rregullatore dhe bursat e mallrave, si dhe çdo taksë dhe detyrim transferimi. Ato përjashtojnë transportin dhe kostot e tjera të nevojshme për të çuar pasuritë në treg.

Trajtimi i fitimit/humbjes

- Fitimi nga njohja fillestare e pasurive biologjike me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes, dhe ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot për shitjen e pasurive biologjike gjatë një periudhe, përfshihen në fitim ose humbje.
- Një fitim nga njohja fillestare (p.sh. si rezultat i korrijës) të prodhimit bujqësor me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes përfshihen në fitim ose humbje për periudhën në të cilën ai lind.

(c) SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë

SNRF 13 përcakton vlerën e drejtë si çmimin që do të merrej për të shitur një pasuri ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Objektivi i një matjeje me vlerën e drejtë është të vlerësojë çmimin me të cilin një transaksion i rregullt shitja e pasurisë ose transferimi i detyrimit do të ndodhte ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut. SNRF 13 zbatohet për SNRF-të që kërkojnë ose lejojnë matjet e vlerës së drejtë ose dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me matjet e vlerës së drejtë (dhe matjet, të tilla si vlera e drejtë minus kostot për shitje, bazuar në vlerën e drejtë ose dhënien e informacioneve shpjeguese për këto matje), përveç në rrethana të caktuara.

SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë ofron udhëzimin për matjen e vlerës së drejtë, duke përfshirë sa vijon:

- Një entitet merr parasysh karakteristikat e pasurisë ose detyrimit që matet që një pjesëmarrës tregu do të merrte parasysh kur vendoste çmimin e pasurisë ose detyrimit në datën e matjes (p.sh. gjendja dhe vendndodhja e pasurisë dhe çdo kufizim në shitjen dhe përdorimin e pasurisë)
- Matja e vlerës së drejtë supozon një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut.
- Matja e vlerës së drejtë supozon një transaksion që kryhet në tregun kryesor për pasurisë ose detyrimin, ose në mungesë të një tregu kryesor, tregu më i favorshëm për pasurinë ose detyrimin.
- Matja e vlerës së drejtë të një pasurie jofinanciare merr parasysh përdorimin më të lartë dhe më të mirë të tij.
- Një matje me vlerën e drejtë të një detyrimi financiar ose jofinanciar ose të instrumenteve të kapitalit të vet të një entiteti supozon se i transferohet një pjesëmarrësi tregu në datën e matjes, pa shlyerje, shuarje ose anulim në datën e matjes.
- Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës (rrezikun që njësia ekonomike nuk do të përmbushë një detyrim), duke përfshirë rrezikun kreditor të një entiteti dhe marrjen e të njëjtit rrezik të mosperformancës përpara dhe pas transferimit të detyrimit.
- Një përjashtim opsional zbatohet për pasuri dhe detyrime financiare të caktuara me pozicione kompensuese në rreziqet e tregut ose rrezikun e kredisë së palës tjetër, me kusht që të plotësohen kushtet (kërkohet zbulim shtesë).

Hierarkia e vlerës së drejtë

Për të rritur konsistencën dhe krahasueshmërinë në matjet e vlerës së drejtë dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse, SNRF vendos një hierarki të vlerës së drejtë që kategorizon në tre nivele të dhëna për teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë. Hierarkia e vlerës së drejtë i jep përparësinë më të lartë çmimeve të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime identike. (Inputet e nivelit 1) dhe prioriteti më i ulët për inputet e pavëzhgueshme (Inputet e nivelit 3). Inputet e nivelit 1 janë çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrime identike që entiteti mund të ketë akses në datën e matjes. Inputet e nivelit 2 janë inpute të ndryshme nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të vëzhgueshme për pasurinë ose

detyrimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Inputet e nivelit 3 janë të dhëna të pavëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin.

(d) SNRF 9 Instrumentet financiare

Njohja fillestare

Pasuria financiare ose detyrimi financiar duhet të njihet në pasqyrën e pozitës financiare kur entiteti raportues bëhet palë në kushtet kontraktore të instrumentit.

Matja fillestare e instrumenteve financiare

Instrumentet financiare fillimisht maten në vlerën e drejtë të konsideratës së dhënë ose pranuar (dmth. kosto) plus (ose minus në rastin e detyrimeve financiare) kostot e transaksionit që janë direkt të atribueshme në blerje ose emetim të instrumenteve financiare.

Përfshirja e kësaj rregulle është kur instrumenti financiar është përcaktuar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (ky term është shpjeguar më poshtë). Në këtë rast kostot e transaksionit nuk janë shtuar në vlerën e drejtë në njohjen fillestare.

Klasifikimi dhe matja e pasuese e pasurive financiare

Pas njohjes fillestare, SNRF 9 kërkon që një entitet të matë pasuritë financiare ose sipas koston së amortizuar, vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse ose vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duke u bazuar në:

- Modelin e biznesit të entitetit për menaxhimin e pasurive financiare
- karakteristikat e rrjedhave kontraktuale të parasë të pasurisë financiare

Një pasuri financiare matet sipas koston së amortizuar nëse të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- Pasuri mbahen brenda një modeli të biznesit objektiv i të cilit është të mbajë pasurinë me qëllim të arkëtimit të rrjedhave kontraktuale të parasë.
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare shkaktojnë në datat e specifikuara rrjedha monetare të cilat janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe të interesit për shumën e papaguar të kryegjësë.

Pas njohjes fillestare, të gjitha pasuritë financiare përveç atyre të mbajtura sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duhet të rimaten ose sipas vlerës së drejtë ose koston së amortizuar.

SNRF 9 lejon opcionin që fillimisht të matet një pasuri financiare sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kur një mospërputhje do të krijohej ndërmjet një pasurie dhe detyrimi të lidhur më të. Në këtë rast, pasuria gjithashtu do të matët më pas sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Fitimet dhe humbjet

Instrumentet në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes: fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje.

Instrumentet financiare të bartura në koston e amortizuar: fitimet dhe humbjet njihen në fitim dhe humbje si rezultat i procesit të amortizimit dhe kur pasuria nuk njihet.

Pasuritë financiare të mbajtura brenda një modeli të biznesit objektivi i të cilit arrihet edhe duke arkëtuar rrjedhat kontraktuale të parasë e edhe duke shitur pasuritë financiare duhet të maten sipas vlerës së drejtë me përfitimet dhe humbjet të njohura në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

3.

a) Më 1 prill 2023, Fan Noli sh.a i dha me lizing Faik Konica sh.a-së një ekskavator për 4 vjet. Ekskavatori kishte një vlerë të drejtë prej €1,240,000 në atë datë. Pagesat e lizingut u ranë dakord për €200,000, €180,000, €160,000 dhe €52,000 respektivisht në vitin 1, vitin 2, vitin 3 dhe vitin 4 (të pagueshme me 1 prill çdo vit, duke filluar nga 1 prill 2023).

Ekskavatori u ble nga Fan Noli sh.a më 1 janar 2023 me një kosto prej €1,200,000 dhe kishte një jetë të dobishme ekonomike prej 8 vite në atë datë. Fan Noli sh.a zhvlerëson ekskavatorët me metoden drejtvizore. Vlera e mbetur e ekskavatorit është zero.

Kërkohet:

Këshilloni Fan Noli sh.a-në se si duhet të trajtohet ekskavatori i dhënë me qira në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse). (11 pikë)

b) Më 1 tetor 2023 Papa Kristo Negovani sh.a ka marrë me lizing një ndërtesë nga Parashqevi Qiriazhi sh.a. Periudha e lizingut ishte 10 vite ndërsa ndërtesa kishte një jetë të dobishme ekonomike prej 50 viteve në atë datë.

Lizingu ka një vlerë të drejtë prej €840,000 më 31 dhjetor 2023.

Qiratë vjetore të lizingut ishin rënë dakord në €86,000 të pagueshme më 1 tetor të çdo viti duke filluar nga 1 tetor 2023. Marrëveshja e lizingut kishte një normë implicite të interesit vjetor prej 12%.

Papa Kristo Negovani sh.a ka një politikë të rivlerësimit të të gjitha ndërtesave çdo 31 dhjetor.

Tabela e faktorëve të skontimit për normën e interesit prej 12% është si në vijim.

| | Faktori i skontimit | Kumulativ |
|---------|----------------------------|------------------|
| Viti 1 | 0.893 | 0.893 |
| Viti 2 | 0.797 | 1.690 |
| Viti 3 | 0.712 | 2.402 |
| Viti 4 | 0.636 | 3.037 |
| Viti 5 | 0.567 | 3.605 |
| Viti 6 | 0.507 | 4.111 |
| Viti 7 | 0.452 | 4.564 |
| Viti 8 | 0.404 | 4.968 |
| Viti 9 | 0.361 | 5.328 |
| Viti 10 | 0.322 | 5.650 |

Kërkohet:

Këshilloni Papa Kristo Negovani sh.a-në si duhet të trajtohet ndërtesa e marrë me lizing në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse)). (9 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës 3.

a)

Trajtimi i kësaj marrëveshjeje në pasqyrat financiare të Fan Noli sh.a varet nëse bëhet fjalë për një lizing financiar apo një lizing operativ. Kjo është për shkak se SNRF 16 *Lizingjet* kërkon që qiradhënësit të klasifikojnë lizingjet ose në lizingje financiare ose në lizingje operative bazuar në dispozitat e marrëveshjeve të lizingut. Prandaj, duhet të shikohen kushtet e marrëveshjes për të përcaktuar trajtimin e duhur kontabël për marrëveshjen e lizingut. Marrëveshja parashikon një periudhë qiraje prej 4 vjetësh, e cila nuk është thelbësore në krahasim me jetëgjatësinë e dobishme ekonomike të ekskavatorit prej 8 vjetësh. Kjo tregon ekzistencën e një lizingu operativ. Duke qenë një lizing operativ, Fan Noli sh.a do të njohë ekskavatorin në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023 nën pasuritë afatgjata që i nënshtrohen zhvlerësimit. Kjo jep €1,050,000 (L1). Ngarkesa e zhvlerësimit prej €150,000 (L1) do të ngarkohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Të ardhurat nga lizingu do të njihen në bazë lineare. Kjo rezulton në të ardhura prej €148,000 (L2) që do të paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Megjithatë, Fan Noli sh.a do të njohë të ardhurat nga lizingu për nëntë muaj prej €111,000 ($€148,000 \times 9/12$) në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Më tej, Fan Noli sh.a do të njohë shumën e mbipaguar nga Faik Konica sh.a prej €89,000 ($€200,000 - €111,000$) tek detyrimeve afatshkurta në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023.

L1

| | |
|------------------------------------|-----------------|
| Pasuritë jo-qarkulluese | €'000 |
| Eksavatori | 1 200.00 |
| Minus: Zhvlerësimi (€1,200/8 vite) | <u>(150.00)</u> |
| Vlera bartëse | 1,050.00 |

L2

| | |
|---------------------------------------|---------------|
| Të hyrat nga lizingu | €'000 |
| Viti 1 | 200.00 |
| Viti 2 | 180.00 |
| Viti 3 | 160.00 |
| Viti 4 | <u>52.00</u> |
| Total | 592.00 |
| Të hyrat vjetore (€592/4 vite) | 148.00 |

b)

SNRF 16 *Lizingjet* ofron një model të vetëm kontabël të lizingmarrësit, që kërkon që lizingmarrësit të njohin pasuritë dhe detyrimet për të gjitha lizingjet, përveç rasteve kur afati i lizingut është 12 muaj ose më pak ose pasuria bazë ka një vlerë të ulët. Prandaj, pavarësisht se periudha e lizingut prej 10 vitesh nuk është e konsiderueshme në krahasim me jetëgjatësinë e dobishme ekonomike të ndërtesës prej 50 vjetësh, Papa Kristo Negovani sh.a-së ende i kërkohet të njohë një pasuri me të drejtë përdorimi dhe një detyrim ndaj lizingut.

Pasuria me të drejtën e përdorimit matet fillimisht me shumën e detyrimit të lizingut plus çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar nga lizingmarrësi. Kjo është €544,208 (L1). Ndërtesa më

pas do të rivlerësohet në €840,000. Kjo pasi Papa Kristo Negovani sh.a ka një politikë të rivlerësimit të të gjitha ndërtesave të saj. Fitimi nga rivlerësimi prej €309,397.20 (L11) do të paraqitet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Përveç kësaj, zhvlerësimi dhe interesi i lizingut për vitin prej €13,605.20 (L11) dhe €13,746.24 (L12) përkatësisht, do të ngarkohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Papa Kristo Negovani sh.a do të njohë detyrimin ndaj lizingut prej €44,761.28 (L12) në detyrimet afatshkurta dhe €427,192.96 (€471,954.24 - €44,761.28) L12 në detyrimet afatgjata në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023.

L1 1

| Pasuritë jo-qarkulluese | €'000 |
|---|--------------------|
| Pasuria me të drejtë të përdorimit (458,208 L12 + 86,000) | 544,208.00 |
| Minus: Zhvlerësimi (€544,208/10 vite) x 3/12 muaj | <u>(13,605.20)</u> |
| Vlera bartëse para rivlerësimit | 530,602.80 |
| Teprica e rivlerësimit (sal. bal) | <u>309,397.20</u> |
| Shuma e rivlerësuar | 840,000.00 |

L1 2

| Detyrimi ndaj lizingut | € |
|--|-------------------|
| VT e pagesave te lizingut (€86,000 x 5.328*) | 458,208.00 |
| Interesi @12% x 3/12 muaj | <u>13,746.24</u> |
| | 471,954.24 |

* faktori kumulativ i skontimit për 9 vjet, pasi që lizingu paguhet ne fillim te vitit.

Detyrimi afatshkurtë €86,000 - €41,238.72 (9/12 x 12% x 458,208) = €44,761.28

4. Luigj Gurakuqi sh.a është një shitës me pakicë i produkteve të ndryshme harduerike. Kompania ka mbi pesë (5) vjet që funksionon. Drejtorët e Luigj Gurakuqi sh.a ishin të shqetësuar për performancën e përgjithshme të kompanisë në vitin 2022 që i atribuohet kryesisht konkurrencës së ashpër me të cilën përballlet. Prandaj, drejtorët zbatuan strategjitë e mëposhtme në vitin 2023 në mënyrë që të përmirësonin performancën e kompanisë.

Strategjitë 2023:

1. Ruajten çmimin e shitjes, por vendosen zbritje në para prej 10% për blerjet e përsëritura. Ata gjithashtu prezantuan zbritjen e pagesës së hershme prej 5%.
2. U bë rivlerësimi i pronave për të pasqyruar vlerën e tyre aktuale.
3. Ngrirja e rritjes së pagave për dy vjet duke filluar nga viti 2023.
4. Krijuan një skeme përfitimi të kontributeve të përcaktuara për punonjësit e kompanisë.
5. Përmirësuan menaxhimin e stoqeve nëpërmjet kompjuterizimit. Për këtë qëllim janë blerë dhe instaluar dhjetë (10) kompjuterë.
6. Shitën pasuritë e vjetra jo-qarkulluese nëpërmjet shitjes me ankand.
7. Filluan të blejnë me shumicë për të përfituar nga zbritjet e blerjeve me shumicë.
8. Rritën pagesën (dividenden) për aksionarët në €320,000 në 2023 nga €180,000 në 2022.

Informatat tjera

- a) Çmimet e karburanteve u rritën me 10%
- b) Tarifat e energjisë elektrike u rritën me 60%

Më poshtë janë pasqyrat financiare të Luigj Gurakuqi sh.a për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:

| | 2023 | 2022 |
|--|----------------|----------------|
| | €'000 | €'000 |
| Shitjet | 7,603 | 6,336 |
| Kosto e shitjes | <u>(2,419)</u> | <u>(1,901)</u> |
| Fitimi bruto | 5,184 | 4,435 |
| Të ardhurat tjera – përfitimi nga shitja e pasurive jo-qarkulluese | 1,152 | - |
| Kosto e shpërndarjes | (1,692) | (1,109) |
| Kosto administrative | (3,024) | (1,901) |
| Kosto financiare | <u>(300)</u> | <u>(528)</u> |
| Fitimi para tatimit | 1,320 | 897 |
| Tatimi | <u>(92)</u> | <u>(179)</u> |
| Fitimi për periudhën | 1,228 | 718 |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse: | | |
| Përfitimi nga rivlerësimi | 720 | - |
| Neto përfitimi nga vlerësimi i eksperteve aktuar | <u>76</u> | <u>-</u> |
| Total të ardhurat gjithëpërfshirëse | 2,024 | 718 |

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor:

| | 2023 | 2022 |
|--|--------------|--------------|
| | €'000 | €'000 |
| Pasuritë | | |
| <i>Pasuritë jo-qarkulluese</i> | | |
| Pasuritë e patundshme, imp. e prodh. dhe paisjet | 3,637 | 4,469 |
| Pasuritë e patrupëzuara | <u>726</u> | <u>915</u> |
| | 4,363 | 5,384 |
| <i>Pasuritë qarkulluese</i> | | |
| Stoqet | 1,188 | 317 |
| Të arkëtueshmet tregtare | 648 | 494 |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | <u>829</u> | <u>73</u> |
| | <u>2,665</u> | <u>884</u> |
| Total pasuritë | 7,028 | 6,268 |
| Ekuiteti dhe detyrimet | | |
| <i>Ekuiteti</i> | | |
| Aksionet e zakonshme prej €4 secila | 920 | 920 |
| Komponentë të tjerë të ekuitetit | 676 | 512 |
| Fitimet e mbajtura | <u>1,852</u> | <u>944</u> |
| Total ekuiteti | 3,448 | 2,376 |
| <i>Detyrimet afatgjata</i> | | |
| Përfitimet e punonjësve | 749 | - |
| Tatimi i shtyrë | 309 | 412 |
| Kredi bankare e siguruar | <u>1,500</u> | <u>2,641</u> |
| | 2,558 | 3,053 |
| <i>Detyrimet afatshkurtra</i> | | |
| Të pagueshmet tregtare | 740 | 342 |
| Tatimi | 57 | 99 |
| Kosto financiare e pagueshme | <u>225</u> | <u>398</u> |
| | <u>1,022</u> | <u>839</u> |
| Total detyrimet | <u>3,580</u> | <u>3,892</u> |
| Total ekuiteti dhe detyrimet | 7,028 | 6,268 |

Kërkohet:

Shkruani një raport për drejtorët që vlerëson ndikimin e strategjive të prezantuara në 2023 në pozitën dhe performancën e Luigj Gurakuqi sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse). (20 pikë)

Zgjidhja e detyrës 4.

Për: Drejtorët e Luigj Gurakuqi sh.a

Nga: Kontabilisti

Data: 23.06.2024

Tema : Vlerësimi i ndikimit të strategjive në pozitën dhe performancën financiare të Luigj Gurakuqi sh.a

Hyrje

Vlerësimi i ndikimit të strategjive të prezantuara dhe të zbatuara në vitin 2023 në pozicionin dhe performancën e Luigj Gurakuqi sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 bazohet në informacionin e dhënë dhe koeficientët e llogaritur për dy vjet.

Vlerësimi i pozitës dhe përfomancës financiare

Fitim-prurja

Shitjet janë rritur me 20% L11. Kjo kryesisht i atribuohet aplikimit së zbritjes në para prej 10% për blerjet e përsëritura.

Marzhi i fitimit bruto ka pak rënie pak nga 70% në 68% L11. Në mënyrë të ngjashme, marzhi i fitimit operativ ka rënie nga 22% në 21% L11. Rënia e marzhit bruto të fitimit mund t'i atribuohet rritjes së kostos direkte të shitjes, e cila duhet të ketë kompensuar çdo zbritje që gëzon Luigj Gurakuqi sh.a nga blerja me shumicë. Ulja e marzhit të fitimit operativ është kryesisht për shkak të rritjes së kostove të shpërndarjes dhe administrative. Kostoja e shpërndarjes është ndikuar negativisht nga rritja e kostos së karburantit dhe nivelit të aktivitetit të evidentuar nga rritja e shitjeve. Kosto administrative është rritur kryesisht me për shkak të rritjes prej 60% të tarifave të energjisë elektrike, kompjuterizimi i menaxhimit të stoqeve, zbritja e pagesave të hershme, rritja e kostos së ruajtjes së stoqeve si pasojë e blerjes me shumicë dhe prezantimit të një plani përfitimesh të përcaktuara pavarësisht kursimeve nga ngrirja e rritjes së pagave. Kostoja e shpërndarjes dhe kostoja administrative u rritën përkatësisht me 53% dhe 59%.

Për më tepër, rillogaritja e fitimit operativ, duke injoruar të ardhurat e papërsëritshme nga nxjerrja jashtë përdorimit të pasurive jo- qarkulluese prej €1,152,000 në 2023 jep €468,000 në 2023. Kjo do të ndryshojë marzhin e fitimit operativ në 6% në 2023.

Kthimi nga kapitali i angazhuar është rritur pak nga 26% në 27% L11. Duket se fitimi nga rivlerësimi, rritja e fitimit operativ dhe ulja e totalit të pasurive, si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit, pothuajse kanë anuluar njëra-tjetrën. Megjithatë, fitimi i rillogaritur prej €468,000 do të tregonte një rënie materiale në kthimin e kapitalit të angazhuar në 8% ($\frac{€468,000}{€6,006,000}$)

Likuiditeti dhe kapitali qarkullues

Koeficienti qarkullues është rritur nga 1.05 në 2.61 L12. Koeficienti i shpejtë është rritur gjithashtu nga 0.68 në 1.45 L12. Ndryshimi në këta koeficientë është kryesisht për shkak të rritjes së ndjeshme të stoqeve dhe parasë dhe ekuivalentit të saj. Më tej, qarkullimi i stoqeve është rritur nga 61 ditë në 179 ditë. Kjo është për shkak se blerja me shumicë nuk është në përpjesëtim me nivelin e aktivitetit. Kjo do të rrisë rrezikun e vjetërsimit të mallrave.

Periudha e arkëtimit të të arkëtueshmeve tregtare është rritur nga 28 ditë në 31 ditë L12. Kjo tregon se zbritja për pagesat e hershme nuk ka dhënë rezultatet e synuara.

Periudha e pagesës së detyrimeve tregtare të Luigj Gurakuqi sh.a është rritur nga 66 ditë në 112 ditë L12. Kjo i atribuohet përqendrimit të kompanisë për të përfituar nga zbritja e blerjes me shumicë. Kjo do të rriste koston e blerjeve në afat të gjatë pasi furnitorët do të ndërpresin zbritjet e ofruara për Luigj Gurakuqi sh.a dhe/ose do t'i shesin mallrat Luigj Gurakuqi sh.a me çmime të fryra për të reflektuar vonesat e pritura në pagesa.

Koeficientët e levës financiare

Niveli i hyrjes nw borxh në terma relativë është ulur nga 53% në 30% (L13) dhe nga 111% në 44% siç mund të shihet nga koeficientët e levës financiare (L13). Duket se Luigj Gurakuqi sh.a përdori disa nga fondet e mbledhura nga nxjerrja jashtë përdorimit të pasurive jo-qarkulluese për të shlyer €1,141,000 (€2,641,000 - €1,500,000) të kredisë së saj të siguar.

Kjo ka ndikuar në rritjen e mbulimit të interesit në 5.4 herë nga 2.7 herë (L13). Megjithatë, përdorimi i fitimit të rillogaritur operativ prej €468,000 tregon se mbulimi i interesit është ulur nga 2.7 herë në 1.56 herë (€468,000/€300,000) pavarësisht zvogëlimit të kredisë së siguar për 43%.

Koeficientët e investimeve të aksionarëve

Fitimet për aksion të Luigj Gurakuqi sh.a janë rritur nga €3.12 në €5.34 (L14). Kjo i atribuohet një rritjeje në fitimprurjen e kompanisë që vjen nga një fitim nga nxjerrja jashtë përdorimit të pasurive jo-qarkulluese prej €1,152,000. Dividenda për aksion u rrit në €1.39 nga €0.78 (L14). Dividenda aktuale për aksion nuk është e qëndrueshme për shkak të përkeqësimit të përfitimit real të kompanisë.

Konkluzion

Strategjitë e prezantuara nga drejtuesit e Luigj Gurakuqi sh.a kanë sjellë përmirësime afatshkurtra dhe në dukje jo të qëndrueshme në fitim-prurjen, likuiditetin, leven financiare dhe koeficientët e investimeve të aksionarëve. Pozita dhe performanca e kompanisë nuk është përmirësuar në terma realë. Prandaj është e nevojshme që kompania të menaxhojë mirë kostot e saj dhe kapitalin qarkullues në mënyrë që ajo të vazhdojë ekzistencën operacionale për të ardhmen e parashikueshme.

Llogaritjet

| | 2023 | 2022 |
|--|------|------|
| L11 | | |
| Koeficientët e fitim-prurjes | | |
| <u>Përqindja e rritjes së shitjeve</u> | | |
| = Ndryshimi në shitje/Shitjet e vitit të kaluar | | |
| = (7,603 - 6,336) / 6,336.00 = 1,267.00 / 6,336.00 | 20% | |
| <u>Norma e kthimit mbi kapitalin e angazhuar</u> = FPIT / KA | | |
| = (1,320+300) / (7,028-1,022) = 1,620.00 / 6,006.00 | 27% | |
| = (897+528) / (6,268 -839) = 1,425.00/5,429.00 | | 26% |

Marxhina e fitimit operativ = FPIT / Shitjet =
 (1,320+300)/ 7,603 **21%**
 (897+528) / 6,336 **22%**

Marxhina e fitimit bruto= FB/Shitjet =
 5,184 / 7,603 **68%**
 4,435 / 6,336 **70%**

Qarkullimi i pasurive= Shitjet/ Kapitali i angazhuar
 7,603.00 / 6,006.00 **1.27**
 6,336.00/5,429.00 **1.17**

Total shpenzimet si % e shitjes = Shpenzimet / Shitjet
 5,016.00/ 7,603.00 **66%**
 3,538.00 / 6,336.00 **56%**

L12 Koeficientët e likuiditetit dhe kapitalit qarkullues

Koeficienti qarkullues = Pasuritë qarkulluese/Detyrimet afatshkurtëra
 2,665.00 / 1,022.00 **2.61**
 884.00/ 839.00 **1.05**

Koeficienti i shpejtë (testi acid) =
 = (Pasuritë qarkulluese - stoqet) / Detyrimet afatshkurtëra
 1,477.00 / 1,022.00 **1.45**
 567.00/839.00 **0.68**

Periudha e qarkullimit të stoqeve =
 = Stoqet / Kosto e shitjeve x 365 ditë
 1,188 / 2,419.00 x 365 **179 ditë**
 317 / 1,901.00 x 365 **61 ditë**

Periudha mesatare e arkëtimit = Të arkëtueshmet tregtare x 365 ditë
 648 / 7,603.00 x 365 = **31 ditë**
 494 / 6,336.00 x 365= **28 ditë**

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme =
 = Të pagueshmet tregtare / Kosto e shitjeve x 365 ditë
 740 / 2,419.00 x 365 **112 ditë**
 342 / 1,901.00 x 365 **66 ditë**

L13 Koeficientët e levës financiare

Hyrja në borxh =
 = Borxhi nga interesi/ (Borxhi nga interesi + Ekuiteti i aksionarëve) x 100%
 1,500.00 / 4,948.00 **30%**
 2,641.00 / 5,017.00 **53%**

Leva financiare = Borxhi nga interesi / Ekuiteti i aksionarëve x 100%
 1,500.00 / 3,448.00 **44%**
 2,641.00/ 2,376.00 **111%**

Mbulimi i interesit = FPIT / Shpenzimet e interesit

1,620.00 / 300.00

5.40

1,425.00 / 528.00

2.70

Përqindja e rritjes së borxhit = (Borxhi aktual-Borxhi i vitit të kaluar) / Borxhi i vitit të kaluar

(1,141.00) / 2,641.00 = -43%

Përqindja e rënies së shpenzimeve të interesit =

= (shpenzimet e interesit të vitit aktual - shpenzimet e interesit të vitit të kaluar) / shpenzimet e interesit të vitit të kaluar (228.00) / 528.00 = -43%

L14 Koeficientët e investimeve të aksionarëve

Fitimi për aksion = Fitimi që ju takon aksionarëve të zakonshëm / Numri mesatar i ponderuar i aksioneve

1,228.00 / 230.00

5.34

718.00 / 230.00

3.12

Mbulimi i dividendës =

= Fitimi që ju takon aksionarëve të zakonshëm / Dividenda e paguar

1,228.00 / 320.00

3.84

718.00 / 180.00

3.99

Dividenda për aksion = Dividenda e paguar / numri i aksioneve

320.00 / 230.00

1.39

180.00 / 230.00

0.78

5.

a) Gavril Dara sh.a kishte humbje tatimore prej €850,000 për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023. Gavril Dara sh.a ka pasur fitime të tatueshme prej €500,000 për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 dhe fitime të tatueshme prej €250,000 për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021. Në juridiksionin e Gavril Dara sh.a, humbjet tatimore mund të rikthehen një vit për të kompensuar fitimet e tatueshme të viteve të mëparshme. Për më tepër, Gavril Dara sh.a rivlerësoi ndërtesat me një vlerë kontabël €8,600,000 në €9,500,000 më 31 dhjetor 2023. Gavril Dara sh.a kishte diferenca të tjera të përkohshme të tatueshme që arrinin në €2,500,000 që kërkonin provizion të tatimit të shtyrë më 31 dhjetor 2023. Nuk kishte saldo të tatimit të shtyrë më 1 janar 2023, por një saldo kreditore të tatimit aktual prej €360,000 për tu kredituar në fitim dhe humbje për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023. Norma e tatimit mbi të ardhurat e Gavril Dara sh.a është 30%.

Kërkohet:

Shpjegoni trajtimin kontabël për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, në përputhje me kërkesat e SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat. (8 pikë)

b) Risto Siliqi sh.a planifikon të zgjerojë rrjetin e ë shpërndarjes duke hapur më shumë pika në qytete të përzgjedhura në Çamëri, Iliridë dhe Kosovën Lindore. Duke qenë se ky plan kërkon më shumë financime për zhvillimin e infrastrukturës, Risto Siliqi sh.a me 1 janar 2023 emetoi fletëobligacione me vlerë nominale prej €8,000,000 të cilat mund të blihen me një premi pas katër viteve të cilat bartin interes prej 8% i pagueshëm çdo vit në fund të vitit. Fletëobligacionet janë emetuar me një zbritje prej 10% dhe Risto Siliqi sh.a ka pasur një kosto emetimi prej €400,000 në datën e emetimit. Fletëobligacionet kanë një normë efektive të interesit prej 12%.

Kushtet kontraktuale të fletëobligacionit shkaktojnë rrjedha të parasë në data të caktuara të cilat janë vetëm pagesa të kyegjësë dhe interesit në kryegjënë e mbetur. Fletëobligacionet nuk mbahen për tregtim dhe në njohjen fillestare nuk janë caktuar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Kërkohet:

Shpjegoni dhe ilustroni se si do të kontabilizohen fletëobligacionet në pasqyrat financiare të Risto Siliqi sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 në përputhje me kërkesat e SNRF 9 Instrumentet financiare. (7 pikë)

c) Petro Nini Luarasi sh.a operon një fabrikë të vogël e cila prodhon rrjeta basketbolli dhe volejbolli. Në datën 1 prill 2021, Petro Nini Luarasi sh.a bleu një makineri për përdorim në fabrikën e saj për €6,000,000. Jeta e saj e dobishme ekonomike është 10 vite dhe makineria zhvlerësohet me metodën lineare (koha e ndarë si në vitet e blerjes ashtu edhe në vitet e largimit). Makina u rivlerësua në €3,900,000 në 1 korrik 2023 pa asnjë ndryshim në jetën e dobishme ekonomike.

Kërkohet:

Shpjegoni dhe ilustroni se si makineria do të matej dhe do të kontabilizohet në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 në përputhje me kërkesat e SNK 16 Prona, impiantet dhe pajisjet. (5 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e detyrës 5.

a) SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat* lejojnë që humbjet tatimore të barten dhe të kompensohen kundrejt fitimeve të mëparshme të tatueshme ose të bartura të kompensohen me fitimet e tatueshme në të ardhmen, me kusht që entiteti të ketë mundësi të gjeneroj fitim. Në rastin e Gavril Dara sh.a, ajo realizoi fitim prej €500,000 në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 dhe fitim prej €250,000 në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021. Humbja prej €850,000 e ndodhur në vitin që përfundon në 31 dhjetor 2023 mund të bartet vetëm një vit më parë, sipas rregullave në juridiksionin e Gavril Dara sh.a., prandaj ata kualifikohen për të ulur fitimin e tatueshëm për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 nga €500,000 në €0.00 duke krijuar një rimbursim tatimor për Gavril Dara sh.a prej €150,000 (30% x €500,000). Për më tepër, meqenëse ka pasur një saldo kreditore në fillim prej €360,000 në llogarinë e tatimit aktual më 1 janar 2023, kjo shumë rritet për t'u kredituar në fitim dhe humbje për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 në €510,000 (€360,000 + €150,000). Në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023, një pasuri tatimore prej €150,000 do të njihet si rimbursim i pritur për shpenzimin e vitit të kaluar.

Ndërkohë, bilanci i humbjes së pakompensuar mbetet €350,000 (€850,000 - €500,000). Nga këndvështrimi i tatimit të shtyrë, diferenca totale e përkohshme është:

| | |
|---|------------------|
| i) Mbi tepricën e rivlerësimit (9,500,000-8,600,000)= | 900,000 |
| ii) Në të tjera = | <u>2,500,000</u> |
| Diferenca totale e përkohshme = | 3,400,000 |

Zbatimi i normës tatimore për të dyja çon në shifrat e mëposhtme të tatimeve të shtyra:

270,000 Teprica e rivlerësimit (në rezervën e rivlerësimit)

750,000 të tjera (për fitim/humbje)

Bazuar në llogaritjet e mësipërme, €270,000 do të zvogëlojë rezervën e rivlerësimit në një saldo prej €630,000 (€900,000 - €270,000), ndërsa €750,000 shkon në fitim ose humbje me gjithsej €1,020,000 detyrim i tatimit të shtyrë në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023. Në përgjithësi, një shumë neto në fitim dhe humbje do të jetë një shpenzim prej €240,000 (€750,000 - €510,000).

| | €'000 |
|--------------------------------------|-------|
| Pasqyra e fitimit ose humbjes | |
| Tatimi mbi të ardhurat | 240 |
| Pasqyra e pozitës financiare | |
| <i>Pasuritë qarkulluese</i> | |
| Rimbursimi i tatimeve | 150 |
| <i>Ekuiteti</i> | |
| Rezerva e rivlerësimit | 630 |
| <i>Detyrimet afatgjata</i> | |
| Tatim i shtyrë | 1,020 |

b) Duke qenë se qëllimi i shënimeve të huasë është që të kryejnë pagesat e principalit plus interesin dhe të mbajnë instrumentin deri në maturim, shënimet e huasë klasifikohen dhe kontabilizohen si një detyrim financiar me kosto të amortizuar. Kjo do të thotë, fillimisht, pasivi matet me vlerën e drejtë minus çdo zbritje në emetim, minus çdo kosto transaksioni si më poshtë:

| | |
|--|--------------|
| | €'000 |
| Vlera e drejtë e shumës më 1 janar 2023 | 8,000 |
| Minus zbritje në emetim (10% x 8,000) | (800) |
| Minus kosto e emetimit | <u>(400)</u> |
| Të ardhurat neto | 6,800 |
| Plus interesin efektiv @12% x 6,800) | 816 |
| Minus interes nominal i paguar @ 8% x 8,000) | <u>(640)</u> |
| Gjendja c/f | 6,976 |

Prandaj, më 31 dhjetor 2023, kostot financiare prej €816,000 do të ngarkohen në fitim ose humbje dhe një detyrim financiar prej €6,976,000 do të njihet në pasqyrën e pozitës financiare.

c) Sipas SNK 16, makineria do të zhvlerësohet me €600,000 në vit nga data e blerjes më 1 prill 2021 deri në datën e rivlerësimit më 1 korrik 2023. Zhvlerësimi total prej €1,350,000 do të ishte ngarkuar në datën e rivlerësimit duke lënë vlerën kontabël prej €4,650,000 (€6,000,000 - €1,350,000). Në të njëjtën datë, pasuria u rivlerësua në €3,900,000 duke shkaktuar humbje nga rivlerësimi prej €750,000 për t'u njohur në fitim ose humbje pasi rivlerësimi që u bë ishte një rivlerësim për herë të parë.

Në datën e rivlerësimit, 2.25 vite nga jeta 10-vjeçare e pasurisë kishin kaluar, duke mbetur 7.75 vite. Meqenëse nuk ka pasur asnjë ndryshim në jetëgjatësinë e pasurisë pas rivlerësimit, shuma e rivlerësuar do t'i nënshtrohet zhvlerësimit duke përdorur jetën e mbetur prej 7.75 vitesh duke dhënë shpenzim zhvlerësimi prej €503,000 në vit (rrumbullakësuar), nga të cilat vetëm 6 muaj zhvlerësimi do të ngarkohet ndërmjet datës së rivlerësimit dhe datës së raportimit 31 dhjetor 2023 prej €251,500 (€503,000 x 6/12). Prandaj, vlera kontabël e makinës në datën e raportimit 31 dhjetor 2023 do të jetë €3,648,500 (€3,900,000 - €251,500).

Llogaritjet

| | |
|---|----------------|
| Kosto në datën e blerjes 1 prill 2021 | 6,000 |
| Zhvlerësimi deri më 31 dhjetor 2021 (10% x 6,000 / 12 x 9) | <u>(450)</u> |
| Shuma kontabël më 31 dhjetor 2021 | 5,550 |
| Zhvlerësimi deri më 31 dhjetor 2022 | <u>(600)</u> |
| Shuma kontabël më 31 dhjetor 2022 | 4,950 |
| Zhvlerësimi deri më 30 qershor 2023 (600 x 6/12) | <u>(300)</u> |
| Shuma kontabël më 30 qershor 2023 | 4,650 |
| Humbje nga rivlerësimi | <u>(750)</u> |
| Shuma e rivlerësuar | 3,900 |
| Zhvlerësimi nga 1 korrik 2023 deri me 31 dhjetor 2023 €3,900/7.75 vjet x 6/12 = | <u>(251.5)</u> |
| Shuma kontabël më 30 dhjetor 2023 | 3,648.5 |

Prandaj, vlera kontabël më 31 dhjetor 2023 do të jetë **€3,648,500**